




Dozë shtesë përforcuese kundër koronavirusit



Nga vjeshta e në vazhdim (muajt shtator/tetor), të gjithë të rriturit (**mbi 18 vjeç**) marrin një ftesë për vaksinim kundër koronavirusit.




Vaksina ju mbron ndaj të sëmururit rëndë pas një infeksioni me koronavirus. Me vaksinën, ka më pak gjasa që ju të shkoni në spital ose të vdisni.




Vaksina ju mbron gjithashtu edhe ndaj variantit Omicron të koronavirusit.



Pas disa muajsh vakcina nuk vepron më aq mirë. Kjo është arsyeja pse është më mirë të merrni një dozë shtesë. Injeksioni shtesë quhet një **dozë përforcuese**.



Në vjeshtë dhe dimër, ne presim që më shumë njerëz të infektohen me koronavirus. Një dozë përforcuese në vjeshtë forcon mbrojtjen e vaksinës.



Një dozë përforcuese në fillim të vjeshtës **rekomandohet fortësisht për personat në rrezik**:


- Personat më të vjetër se 65 vjeç
- Grupet e rrezikut (gratë shtatzëna, personat obezë, personat me imunitet të dobësuar...)
- Personat në kontakt me grupet e rrezikut



Vaksina është e sigurt. Nuk ka të dhëna se një dozë përforcuese pasuese do të shkaktojë më shumë ose efekte anësore të ndryshme në krahasim me dozën e parë përforcuese.



Kur të jetë radha juaj për një dozë përforcuese, personeli në qendrën e receptionit do ju informojë. Mos e humbisni takimin tuaj! Keni pyetje për vaksinimin tuaj? Kontaktini shërbimin mjekësor.



Dhe testohuni nëse përjetoni simptoma të koronavirusit.

MË SKANO

